




Elite Travel Agency

EKSPLORO



BOTËN

UDHËTIM NË JORDANI
13 MARS 2026



FLUTURIMET

Fluturimi Shqipëri – Jordani 25 Nëntor 2026 (Lufthansa Airlines)

Tiranë (TIA) – Frankfurt (FRA) : 06:15 – 08:35

Frankfurt (FRA) – Amman (AMM) : 17:10 – 23:20

Fluturimi Jordani – Shqipëri 01 Dhjetor 2026 (Lufthansa Airlines)

Amman (AMM) – Vienë (VIE) : 17:20 – 19:15

Vienë (VIE) – Tiranë (TIA) : 23:20 – 00:50 (20 Mars)





ITINERARI

Dita 1 : Tiranë – Amman

Takimi me guidën rreth orës 03:30 në aeroport. Nisja nga Tirana në orën 06:15. Udhëtojmë drejt Frankfurtit, mbërrimë në orën 08:35. Marrim fluturimin për në Amman në orën 17:10.

Pas mbërritjes në Aeroportin e Ammanit në orën 23:20, partneri ynë na mirëpret për të siguruar një transferim të rehatshëm drejt Amman-it, kryeqytetit historik të Jordanisë. Akomodohemi në hotel dhe kemi kohë të lirë për t'u çlodhur.

Konsumojmë darkën në hotel. Fjetja në **Khan Khediwe Hotel 4***.

Dita 2 : Amman – Mali Nebo – Petra

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Dita fillon me një vizitë në qytetin e Ammanit. Vizitojmë pikat kryesore historike, këtu duke përfshirë : Citadelën , Xhaminë Blu, Amfiteatrin e qytetit etj.

Vazhdojmë turin tonë për në Malin Nebo, një vend biblik me një rëndësi të madhe shpirtërore, aty ku Moisiu shikoi Tokën e Premtuar dhe më vonë ndërroi jetë. Nga maja e malit, pamjet panoramike përfshijnë Detin e Vdekur, Jerichon dhe Luginën e Jordanisë, duke ofruar një eksperiencë frymëzuese. Mozaikët e mrekullueshëm dhe reliket e kishave të lashta në këtë vend tregojnë për historinë e pasur fetare dhe kulturore.

Pas kësaj vizite të veçantë, udhëtojmë drejt Petra-s, qyteti i gdhendur në shkëmb dhe një nga Shtatë Mrekullitë e Reja të Botës. Këtu do të relaksohemi pas udhëtimit dhe do të përgatitemi për eksplorimin e jashtëzakonshëm të qytetit ditën tjetër.

Konsumojmë darkën në hotel. Fjetja në **Petra Icon Hotel 4***.



ITINERARI

Dita 3 : Vizitë e plotë në Petra – Wadi Rum

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Dita është e dedikuar plotësisht për eksplorimin e qytetit të lashtë të Petrës, i cili është një nga thesaret kombëtare të Jordanisë dhe padyshim atraksioni turistik më i njohur i saj. Petra është trashëgimia e Nabateanëve, një popull arab i zellshëm që u vendos në Jordaninë jugore më shumë se 2,000 vjet më parë. E admiruar për kulturën e saj të rafinuar, arkitekturën masive dhe kompleksin gjenial të digave dhe kanaleve të ujit, Petra është një Vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe një nga Shtatë Mrekullitë e reja të Botës. E banuar nga Nabateanët, Edomitët dhe Romakët, Petra bashkoi njohuritë dhe aftësitë e këtyre qytetërimeve për të krijuar këtë mrekulli botërore. Karvanët e ngarkuar me temjan, mëndafsh, erëza dhe mallra të tjera ekzotike do të pushonin në Petra.

Pas një dite të mbushur me histori dhe emocion, nisemi drejt Wadi Rum, "Lugina e Hënës." Ky peizazh shkëmbor i jashtëzakonshëm, me format e tij unike, është një nga vendet më të qeta dhe mistike të shkretëtirës. Shëtitjet nën qiellin e hapur, plot yje, dhe një darkë tradicionale beduine do ta bëjnë këtë natë të paharrueshme.

Konsumojmë darkën. Fjetja në **Rahayeb Luxury Camp**.

Dita 4 : Wadi Rum Jeep Tour – Aqaba

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin në kamp.

Pas mëngjesit, nisim një tur 2-orësh me jeep 4x4 në Wadi Rum, i portretizuar si Marsi në disa filma artistikë të Hollivudit. Wadi Rum është një përrallë arabe që pret të zbulohet, shtëpia e fiseve nomade beduine, si dhe një vend i qetë për t'u larguar nga epiqendra e Ammanit. Dikur i banuar nga Nabateanët e kohërave parahistorike, Wadi Rum ju lejon të humbeni në peizazhe të gjera dhe vija horizonti në dukje të pafundme.

Pas turit nisemi nga Wadi Rum dhe udhëtojmë drejt jugut për në Aqaba, perlën bregdetare të Jordanisë në Detin e Kuq. Me të mbërritur akomodohemi në hotel dhe më pas shijojmë një tur në këmbë në qytetin e Aqabës për të parë tregun dhe për të shijuar disa ëmbëlsira jordaneze, kohë e lirë në qytet. Shkojmë në hotel për të konsumuar darkën. Fjetja në **La Costa Hotel 4***.



ITINERARI

Dita 5 : Aqaba – Deti i Vdekur

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin.

Pas mëngjesit, eksplorojmë qytetin e Aqaba-s duke vizituar Kështjellën Osmane, një monument historik nga shekulli i 16-të, dhe Arab Revolt Plaza, që përkujton Revoltën Arabe.

Pas këtij turi, udhëtojmë drejt Detit të Vdekur, pika më e ulët në Tokë dhe një prej mrekullive më të famshme natyrore në botë. Këtu do të shijojmë përvojën e notimit mbi ujin e kripur dhe aplikimin e baltës së tij minerale, i cila është e njohur për benefitet e saj terapeutike.

Kthehemi në hotel për të konsumuar darkën. Fjetja në **Crowne Plaza Resort 5***.

Dita 6 : Deti i Vdekur – Jerash – Amman

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel. Më pas do të kemi kohë të lirë për të shijuar bukuritë dhe qetësinë e Detit të Vdekur deri në orën 12:00.

Pas plazhit, transferohemi për të vizituar Jerashin. Jerashi është një përzjerje e mahnitshme e ndikimeve greko-romake dhe orientale. Një vend i shkëlqyer për t'u vizituar gjatë pranverës apo vjeshtës me kodrat e tij të bukura dhe gjelbërimin e harlisur, Jerashi ka një ritëm që nuk shihet askund tjetër në Jordani.

Pas mesditës, udhëtojmë drejt Amman-it për një ndalesë të fundit në zonën e Bulevardit. Për të përfunduar udhëtimin në mënyrë të ëmbël, ndalojmë në një dyqan të famshëm për të shijuar ëmbëlsirën tradicionale "Kynefe / Kunafa".

Kthehemi në hotel për të konsumuar darkën. Fjetja në **Khan Khediwe Hotel 4***.

Dita 7 : Kthimi për në shtëpi

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Kohë e lirë në Amman deri në mesditë. Më pas nisemi drejt aeroportit për t'u kthyer në Shqipëri me kujtime të paharrueshme.

Nisja nga Ammani në orën 17:20.

"Informacion mbi bakshishet në Jordani. Në Jordani, bakshishet janë të zakonshme në hotele, restorante dhe shërbime të ndryshme. Nëse pranoni një shërbim, stafi mund të presë bakshish dhe nganjëherë të jetë pak insistues, pasi kjo është pjesë e kulturës lokale. Nëse nuk dëshironi të jepni bakshish, mjafton ta refuzoni me mirësjellje këtë shërbim shtesë."

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



DETAJET E SHËRBIMIT

Kategoria e Hoteleve: 4* & 5 *

Numri i ditëve: 7

Numri i netëve: 6

Qytetet që vizitohen: 5: Amman, Madaba, Petra, Aqaba, Jerash

Monumentet që vizitohen: 8: The Citadel, The Blue Mosque, The Amphitheater, Mount Nebo, the ancient city of Petra, Wadi Rum, the Aqaba Castle, the Dead Sea, Jerash.

Aktivitetet e përfshira: 4: City tour in Amman, 2 orë – Jeep tour 4x4 in Wadi Rum, traditional dinner in the camp, walking tour in Aqaba.

Numri total i vakteve të përfshira: 12

Mëngjese : 6

Darka: 6

HB në ditët (s): 2, 3, 4, 5, 6

KM: 825 km

Amman – Mount Nebo: ~40 km / 1 orë

Mount Nebo – Petra: ~190 km / 3 orë

Petra – Wadi Rum: ~110 km / 2 orë

Wadi Rum – Aqaba: ~65 km / 1 orë

Aqaba – Dead Sea: ~280 km / 4 orë

Dead Sea – Jerash – Amman: ~140 km / 3 orë

Kohë totale transporti në rrugë tokësore: 14 orë

Distanca mesatare e përkthuar : 137 KM/Ditë

Koha mesatare e transportit : 2.5 orë/ditë

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)

WWW.ELITETRAVEL.AL



HOTELET – AMMAN – KHAN KHEDIWE HOTEL 4*

(4.4 RATING NE GOOGLE DHE 8.7 NE BOOKING)



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



HOTELET – PETRA – PETRA ICON HOTEL 4*

(4.8 RATING NE GOOGLE DHE 9.2 NE BOOKING)



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



HOTELET – AQABA – LA COSTA HOTEL 4*

(4.4 RATING NE GOOGLE DHE 9.1 NE BOOKING)



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



HOTELET – WADI RUM – RAHAYEB LUXURY CAMP

(4.5 RATING NE GOOGLE DHE 8.2 NE BOOKING)



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



HOTELET – DEAD SEA – CROWNE PLAZA RESORT 5*

(4.5 RATING NE GOOGLE DHE 8.1 NE BOOKING)



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



PËRSE TË UDHËTONI ME NE?

- Paketa të kuruara me kujdes për çdo moshë dhe interes
- Eksperiencia autentike kulturore në çdo destinacion. Cdo dite ka nje moment kulminant, qe eshte nje eksperience dhe nje aktivitet, Unesco Sites.
- Grupi optimal: 15–35 persona për një eksperiencë më personale
- Nuk ka kosto të fshehura – transparencë totale në çmim
- Fluturime të organizuara në grup me linja zyrtare per udhetime nderkontinentale ku bagazhet behen me checkin te plote pa dale nga aeroporti (jo low cost të papërshtatshme) – Bagazhet 23 KG gjithmone te perfshira
- Guida profesioniste dhe të përkushtuara, që flasin gjuhën tuaj
- 25 vite përvojë në organizimin e udhëtimeve cilësore
- Kujtime që zgjasin një jetë – jo thjesht një udhëtim
- Mbështetje 24/7 para, gjatë dhe pas udhëtimit
- Programe të pasura në përmbajtje kulturore dhe edukative
- Akomodim në hotele të përzgjedhura me standartin: 4 Superior / 5
- Vizat gjithmone te perfshira ne cmim

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



INFORMACIONE TË RËNDËSISSHME

Kushtet e Rezervimit dhe Pagesës

6.1 Për Shërbimin e paketës “Eksploro Botën”

Klienti pranon të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm për rezervimin e Shërbimit. Pagesa për Shërbimet do të bëhet nga Klienti në mënyrën e mëposhtme:

1. Depozita

- Konfirmimi i rezervimit. Pas konfirmimit të rezervimit, Klienti do të depozitojë shumën prej 25 % të kostos totale të Shërbimit të paketës EB. Kjo depozitë siguron rezervimin e Klientit dhe i lejon Agjencisë të fillojë të bëjë rezervimet e nevojshme.
- Depozitë e Parimbursueshme: 10% e shumës totale të udhëtimit nuk do të jetë e rimbursueshme në asnjë rast nga Operatori i shërbimeve përveç në rrethanat e përcaktuara në Marrëveshje, siç është anulimi nga Operatori i shërbimeve ose ngjarjet e forcës madhore. Kjo politikë është në fuqi për të mbuluar çdo kosto të shkaktuar nga Operatori i shërbimeve në rast të një anulimi.
- Koha e Depozitës: Depozita duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditë pas konfirmimit të rezervimit, kur rezervimi bëhet të paktën 3 muaj përpara. Kjo siguron që Operatori i shërbimeve të ketë kohë të mjaftueshme për të bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për udhëtimin e Klientit.

2. Pagesa e pjesës së mbetur të kostos totale

- Pagesa finale: Bilanci i pagesës duhet të paguhet nga Klienti jo më vonë se 45 ditë para datës së fillimit të shërbimit. Kjo i lejon Agjencisë të konfirmojë të gjitha rezervimet dhe të finalizojë të gjitha përgatitjet.
- Pagesa të Vonuara: Moskryerja e pagesave në kohë mund të rezultojë në moskonfirmimin e rezervimeve pa njoftim të mëtejshëm. Kjo politikë është në fuqi për të siguruar që Operatori i shërbimeve të mund të përmbushë angazhimet e saj ndaj ofruesve të shërbimeve.
- Tarifa për Pagesë të Vonuar: Në rast të pagesës së vonuar, Operatori i shërbimeve mund të vendosë një tarifë shtesë pagese prej 10% të shumës së papaguar. Kjo tarifë kompenson Agjencinë për punën shtesë administrative të përfshirë në trajtimin e pagesave të vonuara.

3. Për rezervimet e kryera/konfirmuara jo më herët se 45 ditë para nisjes së udhëtimit:

Për të gjitha rezervimet e kryera brenda këtij afati (jo më herët se 45 ditë para nisjes së udhëtimit deri në ditën e nisjes), rezervimi quhet i konfirmuar në momentin që është kryer 100% e pagesës.

Anulimi dhe Rimbursimet

7.1 Për Shërbimin e paketës “Eksploro Botën”

Klienti mund të anulojë Shërbimet të paketës EB në varësi të kushteve të mëposhtme:

1. Njoftimi dhe Tarifat e Anulimit

1.Njoftim më shumë se 60 ditë: Anulimet e bëra më shumë se 60 ditë para datës së fillimit të shërbimit do të kenë një tarifë anulimi prej 10% të shumës totale të paketës së turit, tarifë që mbulon kostot administrative që lidhen me anulimin e Shërbimeve të paketës EB.

2.Njoftim më pak se 59 ditë: Anulimet e bëra më pak se 59 ditë para datës së fillimit të shërbimit do të kenë një tarifë anulimi prej 40% të shumës totale të paketës së turit, tarifë që pasqyron vështirësinë e plotësimit të vendit të Klientit me një njoftim të shkurtër.

3.Njoftim më pak se 30 ditë: Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai më pak se 30 ditë përpara udhëtimit, klientit nuk i kryhet asnjë rimbursim nga ana e kompanisë, tarifë që pasqyron vështirësinë në rritje të plotësimit të vendit të Klientit me një njoftim të shkurtër.

4.Mosparaqitje: Në rast mosparaqitjeje, nuk do të jepet rimbursim. Kjo politikë është në fuqi sepse Operatori i shërbimeve do të kishte bërë të gjitha rregullimet e nevojshme dhe nuk do të ishte në gjendje të rikuperonte këto kosto.

5.Anulimi i paketave të shërbimit për kategorinë “Eksploro Botën” mund të realizohet vetëm ndërmjet një kërkesë të paraqitur me shkrim, përmes emailit zyrtar, aplikacionit WhatsApp, ose me paraqitje fizike në zyrat e Elite Travel LCC Tiranë. Çdo kërkesë verbale, telefonike apo e paformalizuara me një dokument të shkruar nuk do të konsiderohet e vlefshme për procedurat e anulimit.

Me kryerjen e rezervimit dhe dërgimin e konfirmimit nga ana e Klientit, pavarësisht formës së tij (me shkrim, elektronik, përmes emailit, WhatsApp-it, pagesës së depozitës apo pagesës së plotë), kjo kontratë konsiderohet e pranuar plotësisht dhe pa asnjë kusht nga Klienti.

Ju lutemi për informacion më të detajuar vizitoni linkun për Kontratën me Klientin. [Klikoni këtu](#)

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



Elite Travel Agency

Everlasting Experiences

WWW.ELITETRAVEL.AL